



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

REKTORATI

Nr. 3635 prot.

Shkodër, më 28.10.2019

URDHËR

Nr. 335 datë 28.10 2019

"PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË PRANIMIT DHE SHQYRTIMIT TË APLIKIMEVE PËR PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020 NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË"

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 112, ligjin nr.10296, dt.08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"(i ndryshuar), ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), Ligjit nr.99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019", VKM-së nr.269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që perjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit"(i ndryshuar), vendimit të Bordit të Administrimit nr.277, dt.14.08.2019 "Për miratimin e tarifës vjetore të shkollimit në programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve për vitin akademik 2019-2020":

Urdhëroj:

1. Fillimin e procesit të pranimit të aplikimeve për përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2019-2020 në programet e studimit të ciklit të parë.
2. Afati i aplikimit është nga data 28.10.2019-18.11.2019
3. Krijimin e komisionit të pranimit dhe shqyrtimit të aplikimeve për përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2019-2020 në programet e studimit të ciklit të parë" i përbërë nga
Saida Bizaku kryetare
Rovena Mesi anëtare
Suzana Rahova anëtare
4. Komisioni mbledh aplikimet e studentëve të rregullt sipas afatit të sipërcituar harton relacionin shoqërues brenda 3 ditëve kalendarike nga përfundimi i afatit për aplikim dhe ia kalon drejtorisë ekonomike, për verifikim përfundimtar.
5. Drejtoria ekonomike pas verifikimit harton materialet e nevojshme për miratimin përfundimtar në Bordin e Administrimit brenda 3 ditëve kalendarike.
6. Specialisti Rovena Mesi e pajisur me user-in për akses në portalin e -albania, do të gjenerojë nga sistemi on-line certifikatat familjare apo personale të çdo aplikanti, pasi ky i fundit ka dhënë pëlqimin për administrimin e të dhënave personale (certifikata).



7. Bashkëngjitur këtij urdhri Deklarata që duhet plotësuar nga studenti aplikant dhe nënshkruar nga specialisti që merr në dorëzim dokumentacionin përkatës si dhe njoftimi me dokumentet që duhen dorëzuar sipas kategorive të përcaktuara në pikën 1 të VKM nr.269 datë 29.03.2017 (i ndryshuar).
8. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri komisioni.
9. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ADMINISTRATORI

Eriklida Shpori



REKTORI

Prof. dr. Adem Bekteshi

